



Në bazë të nenit 17 pika k) dhe nenit 43. të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenit 115 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr. 03/L-154, nenit 4.1 nën a) të Ligjit për pyjet e Kosovës nr. 2003/3 nenit 13. dhe 84 të Ligjit për procedurën administrative nr. 02/L-28, dhe nenit 5 dhe 34 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kuvendi i komunës së Rahovecit në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 QERSHOR 2014 merr

V E N D I M

Për vërtetimin e interesit të veçantë publik për ndërtimin e objekteve banesore kolektive

Neni 1.

Vërtetohet se është me interes të veçantë publik ndërtimi i objekteve banesore kolektive për rastet sociale që do të përfshijnë ngastrat kadastrale nr. 2240/8; 2240/9; 2240/10; 2240/11; 2240/13; 2240/14; 2240/15; 2240/16; 2240/17; 2240/18; 2240/19; 2240/20; 2240/21; 2240/22; 2240/23; 2240/24; 2240/25; 2240/26 dhe 2240/27, të gjitha sipas kulturës kullosë në sipërfaqe prej 4083 m² nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 611 z.k. Rahovec, PSH e Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues Ekonomia e pyjeve Rahovec.

Neni 2.

Ngastrat të cekura nën 1. të këtij Vendimi në sipërfaqe të përgjithshme prej 4083 m², si burim jo drunor, për t,u kthyer në troje do të përdoren nga ana e komunës për ndërtimin banesave kolektive për personat të rasteve sociale dhe të njëjtat do të hiqen nga fondi pyjor dhe do të regjistrohen në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, si bartëse e ardhshme e të drejtës pronësore të subjekt juridik sipas skicës së terrenit të hartuar nga eksperti i gjeodezisë, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 3.

Komuna e Rahovecit garanton se ngastrat të përmendura do të shfrytëzohen për nevoja publike nën autoritetin dhe kontrollin ekskluziv të administratës komunale të cilët nuk janë me ndonjë ngarkesë ligjore në procedure civile, sepse ngastrat të përmendura janë djerrinat në të cilat nuk ekzistojnë pyjet dhe ndodhen në periferi dhe kufizohen me tokën ndërtimore brenda kufirit të banuar të qytetit.

Neni 4

Ky vendim nuk mund të kundërshtohet për aplikim edhe pse shfrytëzuese e ngastrave në fjalë është Ekonomia e pyjeve, pasi që Kuvendit ka vendosur sipas vlerësimit të lirë dhe autorizimit që komuna disponon me pronën shtetërore, pasi që ndërtimi i banesave kolektive për rastet sociale është me interes të veçantë publik, e që sipas dispozitave të nenit 16 al.2 të

Ligjit për konfliktet administrative 03/L-202 ky vendim nuk paraqet akt administrativ, por paraqet akt vlerësimi kundër të cilit nuk është e lejuar të zhvillohet konflikti administrativ.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për urbanizëm dhe shërbime komunale e KK Rahovecit.

Neni 6.

Vendimi hyn në fuqi 8 nga dita e miratimit dhe do të publikohet në Web faqen e komunës.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

01 nr. 53/2014

Rahovec, 27.06. 2014

K r y e s u e s i:

Nahit Elshani